



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura e III-të

Më 11.03. 2008, në ora 10:00

Salla N-225

Komisioni për
Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Procesverbal

Mbledhjen e drejtoi

Myzejene Selmani – kryetare e Komisionit

Morën pjesë:

Et'hem Çeku, Kaqusha Jashari, Haki Shatri, Fatmir Rexhepi, Zef Morina, Safete Hadergjonaj,
Sala Berisha-Shala, Berim Ramosaj dhe Múfera Šinik;

Mungoi: Slobodan Petroviq,

Nga zyra mbështetëse:

Hasan Tahiri dhe Advie Morina

Pjesëmarrës të tjerë: Vjosa Bajraliu nga NDI-ja; Petrit Hysa nga OSCE-ja, Haxhi Gashi nga
USAID-i dhe Lumnije Murati nga Presidenca.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi i Plan programit të punës së Komisionit për vitin 2008
3. Shqyrtimi i Ligjit për ngrohje qendrore sipas vërejtjeve të PSSP-së
4. Të ndryshme;

Myzejene Selmani – kryetare e Komisionit propozoi miratimin e rendit të ditës. Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

I- Miratimi i i procesverbalit të mbledhjes së kaluar (25.02.08);
Procesverbali u miratua me vërejtjen parimore të Zef Morinës se ne procesverbale të përfshihet rezymeja e diskutimit të diskutuesit.

II- Shqyrtimi i Projekt plan programit të punës së Komisionit për vitin 2008

Sala Berisha-Shala propozoi që planit të punës t'i shtohen edhe agjencionet e pavarura; monitorimi i ligjit duhet të behet në kontinuitet e jo me shkëputje; ligji për auditim i vendosur në plan të punës i takon komisionit për buxhet dhe financa; përndryshe plan programi është i mire, tha ndër të tjera ajo.

Ethem Qeku e mbështeti planin e punës por kërkoi që planit të shtohen edhe tri agjencionet e pavarura dhe Kosova C. “

Zef Morina vlerësoi se P. programi është gjithëpërfshirës dhe gjatë vitit sipas nevojës programi ka mundësi të përshtatet. Në vazhdim ai theksoi se në program duhet të parashohim takimet edhe me përfaqësuesit e ART-ës të ZRRE-së të KPMM-së e të TC- “Kosova A e B”

Berim Ramosaj: vlerësoi se Programi është gjithëpërfshirës dhe mund të pasurohet në vazhdimësi ai sugjeroi se duhet të kemi parasysh faktin se ky Komision në kuadër të autorizimeve e përcjellë edhe lëmin e financave përveç fushës së ekonomisë në kuadër të MEF. Bazuar në këtë fakt ai vlerësoi se në kuadër të Plan programit duhet përfshirë edhe këtë lëmi.

Myzejene Selmanai falënderoi grupin punues dhe diskutuesit për propozimet dhe mbështetjen që i bënë P. programit të punës.

Ajo propozoi që në pjesën parimore të shtohet edhe një rregull:

Programi i punës gjatë tërë vitit plotësohet, përshtatet në vazhdimësi në pajtim me kërkesat e komisionit.

Në vazhdim ajo e vuri në votim P. programin së bashku me propozimet e propozuara.

Përfundim.

P. programi së bashku me propozime u votua një zëri.

III-Shqyrtimi i Ligjit për ngrohje qendrore sipas vërejtjeve të PSSP-së

Kryetarja në vazhdimësi i informoi anëtarët e komisionit për rrjedhën procedurale të Ligjit.

Ajo tha se Komisioni për ETIETT i legjislaturës së dytë ka hartuar dhe proceduar P. ligjin për ngrohje qendrore. 02/L-49 të cilin Kuvendi i Kosovës e ka miratua me 03.10.2005.

Zyra e PSSP-së Ligjin nuk e ka shpallur por e ka kthye me disa vërejtje e ndërhyrje të cilat në përgjithësi janë të natyrës juridike, teknike e gjuhësore.

Administrata për mbështetje të punës së komisionit, tekstin e Ligjit e ka korrigjuar sipas vërejtjeve të zyrës ligjore të PSSP-së.

Tani detyra e komisionit është që të shqyrtojë dhe përcaktohem për secilin ndryshim e ndërhyrje në tekstin e Ligjit për ngrohje qendrore.

Në vazhdim kryetarja propozoi që në pikën 3.1 përkufizimi “Ngrohja nga hedhurinat” fjala “djegëje” të zëvendësohet me ndonjë shprehje tjetër.

Fatmir Rexhepi, propozoi që teksti i përkufizimit “Ngrohja nga hedhurinat” të zëvendësohet si vijon:

“Ngrohja nga hedhurinat”-nënkupton ngrohjen e fituar me riciklimin e mbeturinave për djegëje e që mund të përdoret për ngrohje.

Përfundim:

Komisioni i miratoi të gjitha ndryshimet një nga një dhe në tërësi me votë unanimitet së bashku me ndryshimin, lidhur me përkufizimin nën 3.1 “Ngrohja nga hedhurinat”

IV-Të ndryshme:

1.Kryetarja i informoi të pranishmit se i njëjti Komision nga Legjislatura e dytë kishte zhvilluar procedurën e hartimit të P. ligjit për Rregullatorin për ujëra, ujëra të zeza dhe mbeturina e që nuk ka përfunduar për shkak të skadimit të mandatit të legjislativës së dytë. Në vazhdim ajo propozoi që të njëjtën nismë për hartimin e ligjit, përsëri ta ndërmerr komisioni për ETIETT.

Përfundim

Komisioni u pajtua një zëri me këtë propozim:

Në vazhdim Komisioni zgjodhi nën komisionin për hartimin e P. ligjit për shfrytëzimin ekonomik të ujëra, ujëra të zeza dhe të mbeturina, si vijon:

1. Myzejene Selmani, raportuese
2. Berim Ramosaj
3. Sala Berisha –Shala.
4. Përfaqësuesi nga MMPH;
5. Përfaqësuesi nga N. Publike
6. Hasan Tahiri nga zyra mbështetëse.

Komisioni përfundoi një zëri me rekomandimin në vijim:

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të Kosovës që të miratoi:

-Nismën e Komisionit për ETIETT për hartimin e P. ligjit për shfrytëzimin ekonomik të ujërave, ujërave të zeza dhe të mbeturinave dhe të zgjedhjes së nën komisionit për hartimin e P. ligjit.

2. Në vazhdim kryetarja propozoi që të formohet një grup punues që dot ketë për detyrë që të shqyrtoj dhe prezantoi para komisionit vërejtje sugjerime e amendamente në P. ligjin për ndryshim dhe plotësim të L. për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si vijon:

1. Safete Hadërgjonaj– raportues
2. Fatmir Rexhepi
3. Kaqusha Jashari
4. Et’hem Ceku

Komisioni u pajtua një zëri për grupin punues që do të shqyrtoj P. ligjin.

3. Kryetarja propozoi që të formohet grupi punues për P. ligjin për vendosjen e taksës si vijon:

1. Zef Morina- raportues
2. Haki Shatri
3. Mufera Sinik.
4. Slllobodan Petroviq

Detyrat e grupeve punuese janë: të shqyrtoi dhe të propozojë amendamente (nëse vlerëson se janë të nevojshme) duke i arsyetuar propozimet.

Komisioni një zëri u pajtua edhe më këtë propozim.

Në vazhdim komisioni votoi një zëri përsëri përfundimin e mbledhjes së 25.02.2008 e cila i drejtohet njësisë së standardizimit dhe përafrimit me legjislacionin, si vijon:

Komisioni për ETIETT i rekomandon:

Njësisë së standardizimit dhe përafrimit me legjislacionin që të vlerësoi përmbushjen e kërkesave të standardizimit sipas kompetencës për P. ligjet

I-Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të L. për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

II- Projektligjin për vendosjen e taksës.

Kryetarja sipas konkluzionit të mbledhjes së fundit (25.02.08) prezantoi planin e vizitave të grupit punues që do t'i bëjë institucioneve si dhe temat që dot shqyrtohen gjatë muajit mars/08.

-Vizita në MEM me 19.03, ku tema për trajtim do të jetë : Situata aktuale dhe plani strategjik afat shkurtër dhe afat gjatë në fushën e energjisë.

-Vizita në KEK me 24.03, tema për trajtim do të jetë: importi, furnizimi, inkasomi, plani veprues për furnizim të mëtejshëm e tjerë.

-Vizita në TC- Kosova A dhe Kosova "B" tema për trajtim do të jetë:(situata aktuale e përgjithshme - gjendja tekniko funksionale e blloqeve prodhuese.

-Vizita në MTT me 31.03. tema për trajtim do të jetë: Projektet zhvillimore e financuese të infrastrukturës rrugore e tjera.

Berim Ramosaj vlerësoi se Komision funksional nuk duhet te shkojë neper ministri, por duhet të ndodhë e kundërta. Sipas nevojës komisioni funksional do t'i ftojë për të ofruar informata të nevojshme përkatëse. Ai vlerësoi se agjencionet e pavarura, ndërmarrjet publike, bizneset si dhe institutet tjera të pavarura sipas nevojës duhet t'i vizitojmë por edhe mund t'i ftojme në takimet tona.

Fatmir Rexhepi u pajtua me parafolësin se Komisioni nuk duhet të vizitoi Ministrinë por nëse është e nevojshme duhet të ftohen për pjesëmarrje dhe raportime, përfaqësuesit e ministrive, në mbledhjet e komisionit.. Ndërmarrjet publike komunat ose projektet e mëdha me interes, kudo që janë neper komuna duhet dhe mund t'i vizitojmë, përfundoj Rexhepi.

Zef Morina ndër të tjera vlerësoi se interesi i komisionit është që, bashkëpunimi me ministrinë të jetë sa më i mirë. Nëse ne i vizitojmë ministrinë, krijohen parakushte për bashkëpunim konstruktiv. Pajtohemi me rolin mbikëqyrës që ka Komisioni por ne me qëndrimin tonë duhet te

shfrytëzojmë të gjitha format e mundshme që gjerat të zhvillohen në të mirë andaj edhe vizitat tona në ministri e kanë peshën e vetë pozitive, përfundoi Morina.

Ethem Çeku foli për përvojën e tij në të kaluarën duke përkujtuar se në fillim janë ftuar ministrat në mbledhjet e komisionit e pastaj sipas nevojës janë organizuar vizita të cilën përvojë mund ta vazhdojmë edhe tani.

Kaqusha Jashari tha se sipas rregullave të Rregullores së punës në ministrat i ftojme në mbledhjet tona, mirë po nëse vlerësojmë për raste të caktuara se është më funksionale, mund edhe të bëjmë vizita nëpër ministri.

Safete Hadergjonaj vlerësoi se nuk ka gjë të keqe nëse në i vizitojmë ministrat por për takimet e tilla duhet të jemi të përgatitur dhe të kemi edhe agjendën e temave, ndërsa pjesëmarrja e ministrit apo përfaqësuesit të tij në mbledhjet e komisionit është e rregulluar me rregullore dhe nuk ka kontestuese as gjë.

Kryetarja Selmani theksoi se propozimi është bere me qellim të ngritjes së shkallës së bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të ministrisë dhe komisionit duke hapur mundësi dhe forma sa më të shumta në funksion të funksionimit sa ma konstruktiv.

Përfundim:

Komisioni një zërit u pajtua që me datën 24.03.08 do të vizitojë KEK-un dhe TC “Kosova A dhe B” tema:(situata aktuale e përgjithshme - gjendja tekniko funksionale e blloqeve prodhuese)

Në vazhdim kryetarja Selmani e njoftoi Komisionin se në adresën e saj ka ardhur Raporti konsultativ për rishikimin e tarifave të energjisë elektrike nga ZRRE –

Në propozim të kryetares komisioni u pajtua që me datën 13.03.2008 në orën 11.00 të mbahet mbledhje në të cilën do të shqyrtohet Raporti i ZRRE-së.

Në këtë mbledhje ftohet përfaqësuesi i ZRRE-së.

Mbledhja mbaroi në orën 11:30

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani